



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC



DREJTORIA E ARSIMIT

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ,nr.04/L-032 , Udhëzimin Administrativ të MASHT-it, me nr.22/2013, vendimin nga MASH nr.01/B ,Nr.1771, datë 06.08.2020, Drejtoria për Arsim, më 28.06.2021, shpall :

K O N K U R S

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në gjimnaz dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2021-2022, sipas Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (KKK).

1.Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në Gjimnazin “17 Shkurti” në Obiliq dhe SHMLP “Isamil Dumoshi” në Obiliq për vitin shkollor 2021-2022, mund të konkurrojnë kandidatët , të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Republikës së Kosovës , obligohen t’a bëjnë njohjen e certifikatave ose dëftesave në MASH, pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe në shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente :

- Fletëparaqitjen, e cila do të merret në shkollën në të cilën konkurron,
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9)
- Certifikatën e lindjes.

Sqarim: Shkollat duhet të krijojnë kushte për mbajtjen e distancës së nxënësve gjatë konkurrimit të tyre.

3.Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Dorëzimi i dokumenteve për gjimnaz dhe shkollën profesionale për vitin shkollor **2021/2022** , bëhet me datat: **28.06.2021 – 30.06.2021**, në lokalet e shkollës, ku nxënësit dëshirojnë të regjistrohen, duke filluar nga ora **08:00 -16:00.**



Rezultatet për pranimin e nxënësve do të shpallen në shkollat përkatëse me datën **02.07.2021** (**në shkollat ku plotësohet numri i nxënësve**).

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **05.07.2021**.

Kandidati i refuzuar, i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë ankese, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve të paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit, dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASH-it, te komisioni për ankese.

4.Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret :

- 1.Nota mesatare e të gjitha lëndëve (klasa 6-9)..... (60%) 60 pikë
2. Nota mesatare nga lëndët prioritare (klasa 6-9)..... (40%) 40 pikë
- 3.Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaz dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë katër e më lartë (së pari gjendet mesatarja e 4 lëndëve prioritare veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve.

5.Renditja e lëndëve me prioritetet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

I. Gjimnazi i shkencave të natyrës:

1. Lënda :Fizikë
2. Lënda :Kimi
3. Lënda:Biologji
4. Lënda :Matematikë

II. Gjimnazi i shkencave shoqëror dhe gjuhësore :

- 1.Lënda :Gjuhë amtare
- 2.Lënda :Gjuhë angleze
- 3.Lënda:Histori
- 4.Lënda :Gjeografi

Renditja e lëndëve me prioritete sipas profileve në shkollën profesionale

I.Makineri , Elektroteknikë , Kimi-Teknologji

1. Lënda :Fizikë
- 2.Lënda :Kimi
- 3.Lënda:Matematikë
- 4.Lënda :TIK

II. Ekonomi (banka dhe financa)

- 1.Lënda :Gjuhë amtare
- 2.Lënda :Gjeografi
- 3.Lënda:Matematikë
- 4.Lënda :TIK



• **Gjimnazi “ 17 Shkurti “ në Obiliq**

Nr.	Drejtimi	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve
1.	Gjimnazi Natyror	2	64
2.	Gjimnazi shoqëror	1	32
Gjithsej:		3	96

• **SHMLP “ Ismail Dumoshi “ në Obiliq**

Nr.	Drejtimi	Profili	Nr.i paraleleve	Nr.i nxënësve	Vitet e shkollimit
1.	Elektroteknikë	Telekomunikacion	1	24	2+1
		Informatikë	1	24	2+1
		Energjetikë	2	48	2+1
2.	Makineri	Operator prodhimi	1	24	2+1
3.	Kimi-Teknologji	Laborant i kimisë	1	24	2+1
		Gjeologji	1	24	2+1
4.	Ekonomi	Kontabilitet	1	24	2+1
		Banka dhe financa	1	24	2+1
Gjithsej:			9	216	2+1

Drejtori i DA-së: Rexhep Zeka

